



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. ~~1396~~ Prot.

Tiranë, më datë ~~08.11~~ 2023

VENDIM  
Nr. 554, datë 08.11.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.11.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raport i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks banimi me vila 1, 2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë, struktura 3 kat me 1-2 kat parkim nëntokë, strukturë akomoduese 2 kat me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues, në pasuritë nr.857/1/71, në pronë të znj. Fatmire Dragoj dhe Klajd Nano; nr.857/178, në pronë të z. Fatmir Draçi dhe nr. 857/1/88 në pronë të z. Klajd Nano, zk.2529, Njësia strukturore fa/60, fa/44 dhe fa/30, njësia administrative Farkë, me zhvillues “JOY GROUP” Sh.a.;
  2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
  3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nga DRTK Tiranë;
  4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
  5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

